

NewsLetter



Years

THE OFFICIAL NEWSLETTER OF THE AMERICAN CHAMBER OF COMMERCE IN ALBANIA

Vendimet e qeverisë kundër Covid-19.

AKTI NORMATIV

PER KUSHTET DHE KRITERET PËR
PËRFITIMIN NGA SKEMA E GARANCISË
SOVRANE PËR BIZNESET E PREKURA
NGA MASAT E QEVERISË PËR COVID-19

» Në faqen 3

ANALIZË

Si mund të bëhen
pagesat gjatë
Covid-19 duke
mbështetur biznesin



Linda Shomo

EASY PAY

Pandemia e koronavirusit ka gjuhëzuar së fundmi edhe Shqipërinë, duke i dhënë një goditje të fortë biznesit dhe sjelljes konsumatore në tregun shqiptar. Ndërkohë që për disa biznese...

» Në faqen 4

PANDEMIA

AMCHAM I DËRGON QEVERISË SHQIPTARE NJË

letër me katër propozime

Presidenti i Dhomës Amerikane të Tregtisë, Enio Jaço përmes një letre publike drejtuar Qeverisë, ka propozuar katër masa ekonomike për mbrojtjen e biznesit.

Në faqen 2



BIZNESI I MADH

ENIO JAÇO: BIZNESET DUHET TË KENË AKSES NË LIKUIDITET

» Në faqen 2

COVID 19- ECONOMIC NEWS



» Në faqen 7

Masat për COVID-19 / Bankave do t'ju ndalohet për kohësisht nga shpërndarja e fitimeve

Emigrantët e Huaj në Shqipëri, AIDA: Ja çfarë ndryshon në procedurën për të huajt

COVID-19, FSA (AMF) kërkon që kompanitë e sigurimeve të pezullojnë shpërndarjen e dividendëve

Kur dhe si do të përfundojë pandemia e koronavirusit?

AMCHAM I DËRGON QEVERISË SHQIPTARE

NJË LETËR ME KATËR
PROPOZIME

Presidenti i Dhomës Amerikane të Tregtisë, Enio Jaço përmes një letre publike drejtuar Qeverisë, ka propozuar katër masa ekonomike për mbrojtjen e biznesit. Bazuar mbi një pyetësor të zhvilluar me 220 anëtarët e Dhomës Amerikane dhe punën e komitetit të Taksave, atij Ligjor dhe Komitetit të Investimeve, Jaço kërkon nga Qeveria të ndërmerren hapa të vështirë, por kritikë për mbështetjen e punëdhënësve.

“Disa prej tyre po planifikojnë riorganizime të fuqisë punëtore, ndaj mbështetja e punëdhënësve është thelbësore edhe për punonjësit dhe jetike

për ta, familjet e tyre dhe ekonominë tonë.”

Akses të barabartë në fondet e emergjencës Covid-19 për bizneset e të gjitha përmasave dhe lirinë e masave kufizuese për ta, kërkon Dhoma Amerikane.

“Duam të theksojmë rëndësinë e jashtëzakonshme të likuiditetit për bizneset në këtë kohë kritike, si dhe spiralet e rrezikshme ekonomike që mund të vijnë nga mungesa e tij.”

Dhoma kërkon trajtim të barabartë edhe me Pagën e Papunësisë për

punonjësit e çdo biznesi, të vogël, të mesëm apo të madh. Përmasat e biznesit nuk mund të penalizojnë punonjësit që janë pushuar nga puna, apo ata që kanë mbetur në shtëpi për shkak të pezullimit të aktivitetit të biznesit.

Shtyrja e parapagimit të taksave për vitin 2020 theksohet si domosdoshmëri pas masave shtrënguese që shteti ka marrë në luftën kundër Covid-19.

“Rekomandojmë pezullimin e parapagimit të taksave dhe miratimin e një legjislacioni që lejon kompanitë të paguajnë më vonë me këste. Edhe taksat lokale,

sigurimet Shoqërore dhe Tatimi mbi të Ardhurat Personale, të pezullohen të paktën për një periudhë dy mujore.”

Në letrën publike drejtuar Qeverisë, AmCham kërkon gjithashtu pezullimin e borxheve që bizneset i kanë shtetit, deri në rifillimin e aktivitetit normal të tyre. Nga ana tjetër, Qeveria duhet t'i rimbursojë bizneseve TVSH-në e pakredituar në mënyrë sa më të shpejtë dhe të thjeshtë. Edhe këtë herë Dhoma Amerikane e Tregtisë ka kërkuar nga Qeveria që të konsultohet me palët e interesit përpara se të marrë vendime që sjellin pasoja për bizneset.


ENIO JAÇO: BIZNESET DUHET TË
KENË AKSES NË LIKUIDITET

Kreu i Dhomës Amerikane të Tregtisë Enio Jaço ngriti edhe njëherë problemet me të cilat bizneset e mëdha po përballen gjatë krizës së shkaktuar nga pandemia koronavirus. Aksesit në Fondet e Emergjencës, sipas Jaços është thelbësor për të gjitha bizneset. Ky është edhe shqetësimi kryesor i 224 antarëve të Dhomës Amerikane, të cilët kanë plotësuar një pyetësori të zgjeruar.

“Një nga problemet kryesor është ajo e ruajtjes së likuiditetit. Bizneset hasin një ndërprerje apo ngadalësim të aktivitetit për shkak të situatës dhe një pjesë e mirë e tyre, sidomos në Shqipëri ruajnë paratë operacionale vetëm për një periudhë të shkurtër kohe, shpesh herë vetëm një mujore. Paramendoni çfarë mund të ndodhë nëse kjo biznese ngelen pa punuar për 4-5 muaj.”

Fondet e emergjencës mund të ofrojnë akses në mënyra të ndryshme, sipas Jaços por ajo që është e rëndësishme për bizneset e mëdha është pikërisht aksesit në paratë cash.

“Është mirë që biznesin të mos e shohim thjesht si disa subjekte abstrakte por në rradhë të parë si entitete që punësojnë njerëz. Pjesa më vlenarëbël janë punonjësit, të cilët nëse shkarkohen nga puna nisnin një spirale



negative në ekonomi.”

Trajtimi i biznesit të madh me të voglin duhet të jetë i ngajshëm, sipas kreut të Dhomës Amerikane të Tregtisë, pasi nëse një biznes i madh falimenton, një numër shumë i lartë njerëzish mund të mbeten pa punë dhe kjo do të krijojë një impakt shumë të madh social.

AKTI NORMATIV

PER KUSHTET DHE KRITERET PËR PËRFITIMIN NGA SKEMA E GARANCISË SOVRANE PËR BIZNESET E PREKURA NGA MASAT E QEVERISË PËR COVID-19



KUSHTET PËR PËRFITIM

Bizneset duhet të kenë mbyllur aktivitetin ose të kenë pësuar rënie të xhiros sipas listës së subjekteve të prekura nga vendimet e qeverisë kundër Covid-19.

Lista e cila duhet të ishte bashkëngjitur me vendimin në fletoren zyrtare, mungon.

Bizneset duhet të kenë aftësi ripaguese sipas kriterëve të sektorit bankar, dhe kushteve dhe diskrecionit të Bankës së nivelit të dytë që do jape huanë.

Fondet do të përdoren vetëm për të paguar punonjësit, sipas listëpagësive të procesuara në muajin Shkurt.

Nuk përfitojnë nga kjo skemë të gjithë ata (të vetpunësuar dhe biznese të vogla) që kanë përfituar nga skema e subvencionimit të pages, nga ndihma ekonomike apo paga e papunësisë.

Bankat do zbatojnë kriterin "i pari në kohë, i pari në të drejtë".

Brenda 10 ditëve nga momenti i aplikimit banka vendos për miratimin apo jo të kredisë.

MFE mund të ndryshojë kriteret e kualifikimit në çdo kohë, në dakordësi me Bankat e nivelit të dytë, pa efekt prapaveprues për huanat e dhëna deri në atë moment.

KRITERET E KREDISË

Fondet do të kalojnë në llogarinë e punonjësve të biznesit, për të cilat

11 MILIARD LEKË DO I SHPËRNDAHEN 12 BANKAVE TË NIVELIT TË DYTË NË SHQIPËRI SIPAS LISTËS SË MËPOSHTME:

- » "Raiffeisen Bank", sh.a., Albania, në vlerën 1 900 000 000 lekë;
- » "Banka Tirana", sh.a., në vlerën 600 000 000 lekë;
- » "Banka Union", sh.a., në vlerën 600 000 000 lekë;
- » "Banka Intesa Sanpaolo Albania", sh.a., në vlerën 900 000 000 lekë;
- » "Banka Kombëtare Tregtare", sh.a., në vlerën 1 900 000 000 lekë;
- » "Banka OTP Albania", sh.a., në vlerën 1 100 000 000 lekë;
- » "Banka Procredit", sh.a., në vlerën 400 000 000 lekë;
- » "Banka Alpha Albania", sh.a., në vlerën 700 000 000 lekë;
- » "Banka Amerikane e Investimeve", sh.a., në vlerën 500 000 000 lekë;
- » "Banka Credins", sh.a., në vlerën 2 000 000 000 lekë;
- » "Banka e Bashkuar e Shqipërisë", sh.a., në vlerën 100 000 000 lekë;
- » "Banka e Parë e Investimeve, Albania", sh.a., në vlerën 300 000 000 lekë.



banka merr detajimin e fondit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për secilën pagë të deklaruar.

Vlera e huasë në asnjë rast nuk mund të kalojë vlerën e 3 pagave

mujore bruto të punonjësve të deklaruar. Paga e një punonjësi në asnjë rast nuk do jetë më e lartë se 150 000 lekë.

Huadhënësi do të ofrojë huanë me një normë interesi preferenciale,

të barabartë me normën mesatare të interesit të tre ankandeve të fundit të bonove të thesarit 12 mujore plus një marzh prej 0.5%, por në asnjë rast norma e interesit nuk do të jetë më e lartë se 2.85%.

Jetëgjatësia e huasë nuk mund të tejkalojë 2 vite.

Periudha pa pagesë zgjat vetëm 3 muaj nga disbursimi i fondeve.

Sipas marrëveshjes tip të miratuar nga qeveria për dhënien e kredisë me garanci sovraane nga bankat, Ministria e Ekonomisë dhe Financave garanton 100% të principalit të huave, por jo më shumë se totali i marrë Hua nga biznesi. Interesat dhe penalitetet në asnjë rast nuk garantohen nga MFE.

Biznesi që merr huanë duhet të nënshkruajë një Marrëveshje Mirëkuptimi sipas së cilës, në rastet kur Ministria kompenson Bankën për shumën që Biznesi nuk ka arritur të paguajë, ky i fundit bie dakort të bëjë përpjekje të arsyeshme për t'i kthyer Ministrisë së Ekonomisë shumën që ajo i ka paguar Bankës, sëbashku me të gjitha kostot që mund të lidhen me to.

Në rast të kundërt Ministria ka të drejtë të zbatojë ligjin nr. 9665, datë 18.12.2006 "Për huamarrijen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë" si dhe ligje të tjera në fuqi, për të përfituar kthimin e çdo kompensimi të kryer sipas Marrëveshjes së Garancisë.

Nëse në fund të periudhës së huasë, sipas marrëveshjes së garancisë, biznesi nuk i kthen bankës detyrimin, ai humbet të drejtën e aksioneve të cilat do shiten nga strukturat përkatëse sipas legjislacionit në fuqi.



Linda Shomo

EASY PAY

Pandemia e koronavirusit ka gjuhëzuar së fundmi edhe Shqipërinë, duke i dhënë një goditje të fortë biznesit dhe sjelljes konsumatore në tregun shqiptar. Për disa biznese kjo periudhë solli një ulje në shitje. Ndërkohë për disa sektorë në treg si telekomunikacioni, media digjitale, teknologjia, institucionet financiare, institucionet financiare teknologjike (fintech) dhe mjekësia, ajo solli një mundësi për novacion.

Pasojat ekonomike të gjithë kësaj situatë deri më tani janë ende të paqarta, mirëpo masat e ndërmarra në luftën ndaj tij janë drastike, duke krijuar sfida të vërteta për industri të ndryshme. OBSH dhe alarmin për faktin se paraja fizike është një faktor kontribues në përhapjen e virusit Covid-19 (për shembull Kina dhe Korea e Veriut e ndaluan qarkullimin e parasë fizike derisa kryen procesin e plotë të dizinfektimit të tyre). Numri i kërkimeve në internet që kanë të bëjnë me "para" dhe "virus" është në nivele rekord. Të gjitha këto zhvillime kanë detyruar disa biznese në vend të integrojnë në mënyrë të menjëhershme në modelet e tyre të biznesit, tregëtinë dhe paranë elektronike.

Edhe përse duhet të kishte ndodhur kohë më parë, u desh kjo situatë që bizneset shqiptare të integrojnë teknologjinë në strategjitë e tyre. Arsyeja kryesore se përse njerzët së fundmi po kthehen tek zhvillimet online, është për shkak të lëvizjes së kufizuar.

Vëllimi i transaksionit në pagesa në internet po rritet pasi konsumatorët e kufizuar në shtëpitë e tyre po kthehen në kanale dixhitale të blerjes.

Transaksionet globale të e-commerce u rritën 23% në mes të marsit në krahasim me vëllimin tipik javor.

Në vendet e zhvilluara, prej vitesh tashmë, konsumatorët po përfitojnë më të mirën e instrumenteve financiare. Kompani të mirënjohura finantechs, Paypal, Amazon Pay, Apple Pay, Alipay dhe Google Pay, ofrojnë lehtësi në kryerjen e pagesave e shërbimeve financiare, duke ulur kostot dhe burokracitë.

Në tregun shqiptar ka disa kompani FinTech që mundësojnë shërbimin e pagesave on-line duke përdorur

pagesa dixhitale si dhe zgjidhje të tjera të reja financiare. Këto kompani ju ndihmojnë ju të bëni pagesa online për shërbimet utilitare si, faturat e dritave dhe ujit, rimbushje celulari, pagesat e telefonisë fikse, internet dhe IPTV, pagesat e kësteve të mikrokredive, si edhe pagesat për kopshtet apo bileta elektronike. Këto shërbime, veçanërisht pagesa për shërbimet komunale, kanë qenë në një kërkesë të lartë javët e fundit, kështu që numri i pagesave dixhitale, sipas statistikave të ndërmarreve, është më shumë se i dyfishuar muajin e kaluar.

Ndërkohë gjithnjë e më shumë konsumatorë po bëjnë blerje në in-

Si mund të bëhen pagesat gjatë Covid-19 duke mbështetur biznesin



ternet për herë të parë në kategori të reja, veçanërisht në sende ushqimore dhe sende shtëpiake. Shitësit me pakicë kanë parë tashmë një rritje të blerjeve ushqimore në internet pasi konsumatorët rezervojnë ushqime dhe sende të tjera thelbësore. Për të siguruar rimëkëmbjen nga Covid19 në sektorët më të prekur, operatorët e pagesave duhet të reflektojnë se si t'i ndihmojnë klientët e tyre duke përshpejtuar rifillimin e biznesit.

KOMPANITË E PAGESAVE MUNDET, PËR SHEMBULL:

- Të mbështesin shpërndarjen masive të pagesave për ndihmën qeveritare.
- Të sigurojnë një shkëmbim më të lehtë të pagesave në internet. Ata duhet të mbështesin bizneset, veçanërisht NVM-të, duke ofruar atyre mundësinë për të kapërcyer krizën, kryesisht duke ofruar njohuri dhe duke mundësuar pagesa dixhitale.
- Të ndihmojnë bizneset të kuptojnë sjelljen e klientëve të tyre dhe të përshtatin opsionet e tyre të pagesës në përputhje me rrethanat.
- Të thjeshtojnë zinxhirin e furnizimit B2B.

Rregullorja e fundit e Bankës së Shqipërisë, e cila konsistonte në heqjen e të gjitha tarifave që lidhen me transferimet vendore ndërbankare, ishte një hap shumë pozitiv drejt mbështetjes së biznesit. Kjo do të sjellë më shumë përdorim të kanaleve E-banking dhe ndërkohë do të zvogëlojë kostot e tyre.

NË KËRKIM TË NORMALES TJETËR

Ndërsa kriza largohet, ne do të marrim më shumë qartësi në lidhje me thellësinë dhe kohëzgjatjen e dhimbjes që shkaktoi. Një gjë është e qartë tani: nuk do të ketë rikthim në normat e 2019; ndikimi në sjelljen dhe pritshmëritë e klientëve dhe bizneseve – ashtu sikurse e gjithë pëllhura e ekonomisë - do të jetë e thellë. Pra, është e rëndësishme që jo vetëm ekosistemi i pagesave, por edhe ekonomia në tërësi të zhvillohet mbi këto zgjidhje që do të lejojnë ekonomitë të dalin nga kriza aktuale në mënyrë efektive dhe të përcaktojnë të ardhmen e pas-COVID-19



SË BASHKU NE MUND T'A MPOSHTIM

Pagesat online kanë ndihmuar shumë qytetarë të cilët e kanë të pamundur të dalin nga shtëpia



“Tregu i NMV-ve në Shqipëri është akoma në fazat e para të transformimit digjital. Kjo do të thotë që ka një potencial të madh, të pa pazbuluar akoma mbi këtë treg, sikurse ka edhe për pagesat digjitale. Gjatë krizës së Covid19 ne po shohim sesi teknologjia digjitale mund ti ndihmojë bizneset ti përgjigjen më efektivisht tregut që po ndryshon aq shpejt.”

– thotë **Linda Shomo, Drejtore e Easy Pay.**

AmCham është krenare për anëtarët e saj.

Pagesat online kanë ndihmuar shumë qytetarë të cilët e kanë të pamundur të dalin nga shtëpia dhe i ka kursyer atyre rradhët e gjata për të paguar ujin dhe dritat. Edhe bizneset që duhet të paguajnë taksat kanë përdorur aplikacionet e Easy Pay – një rrugë e shpejtë dhe e sigurtë për të paguar detyrimet.

Zgjidhjet digjitale financiare, si aplikacioni Easy Pay, ofrojnë një gamë të gjerë shërbimesh të aksesueshme direkt nga celulari, duke shmangur ekspozimin në ambiente të populluara dhe kontaktin fizik me kartmonedhat.

“Tregu i NMV-ve në Shqipëri është akoma në fazat e para të transformimit digjital. Kjo do të thotë që ka një potencial të madh, të pa pazbuluar akoma mbi këtë treg, sikurse ka edhe për pagesat digjitale. Gjatë krizës së Covid19 ne po shohim sesi teknologjia digjitale mund ti ndihmojë bizneset ti përgjigjen më efektivisht tregut që po ndryshon aq shpejt.” – thotë **Linda Shomo, Drejtore e Easy Pay.**

Dhoma Amerikane, nëpërmjet Komitetit të Biznesit Digjital, përkrah iniciativën e platformave dixhitale si Easy Pay, për funksionalitetin dhe eficientësinë që ato ofrojnë

AK-INVEST QËNDRON NË KËTO DITË TË VËSHËTIRA PRANË NJERËZVE NË NEVOJË.

Kompania Ak-Invest nuk është vetëm një zë i rëndësishëm në tregun financiar jo bankar, por gjithashtu ka një përgjegjësi të lartë të korporatës.



AmCham është krenare për anëtarët e saj.

Thirrjes së Bashkisë së Tiranës për të ndihmuar familjet në nevojë për ti siguruar bazën e nevojshme ushqimore, i është përgjigjur edhe Ak Invest të cilët kanë ndihmuar 10 familje në zonat periferike

të Tiranës.

Kompania Ak Invest e cila aktualisht operon në tregun financiar jo bankar, ka demonstruar se pëveç shërbimeve që ofron në këtë treg, është e aftë dhe të zhvillojë përgjegjësinë e saj sociale.



FOOD ALBANIA I VJEN NË NDIHMË FAMILJEVE NË NEVOJË NËPËRMJET FURNIZIMIT ME USHQIME

Tani ata kanë nevojë për ndihmën e biznesit dhe të qytetarëve që të vazhdojnë misionin e tyre.

“Eksperiencia e reçesioneve ekonomike ka treguar se zbutja e dhimbjes është shumë më efikase kur shteti, komunitetet lokale, biznesi dhe organizatat bashkojnë forcat dhe krijojnë mendësinë e duhur të trajtimit të situatës. Sot, ne bëjmë thirrje për ndihmë emergjente në ushqime, pasi është nevoja primare dhe më urgjente për familjet shqiptare”,

– thotë Drejtor i Food Bank, Oltion Shena.

AmCham është krenare për anëtarët e saj.

Food Bank Albania, pjesë e Federatës Evropiane të Bankave të Ushqimit (FEBA), po përpiqet të rrisë bashkëpunimin e institucioneve, bizneseve dhe organizatave të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, që të ndihmojnë në shpërndarjen e ndihmave ushqimore. Bankat e ushqimit në të gjithë Evropën po ridrejtojnë terpricat ushqimore tek shtresat në nevojë. COVID-19 ka treguar që mund të prekë këdo, por statistikatat tregojnë që më të prekura janë shtresat më vulnerabël si dhe ato më të varfë ekonomikisht.

Për këtë arsye Food Bank Albania kërkon ndihmën e qytetarëve dhe bizneseve, në mënyrë që të vazhdojë të punojë për të ndihmuar familjet që kanë më shumë nevojë për mbështetje.

“Eksperiencia e reçesioneve ekonomike ka treguar se zbutja e dhimbjes është shumë më efikase kur shteti, komunitetet lokale, biznesi dhe organizatat bashkojnë forcat dhe krijojnë mendësinë e duhur të trajtimit të situatës. Sot, ne bëjmë thirrje për ndihmë emergjente në ushqime, pasi është nevoja primare dhe më urgjente për familjet shqiptare”, – thotë Drejtor i Food Bank, Oltion Shena.

Dhoma Amerikane e Tregtisë në Shqipëri falenderon Food Bank për iniciativën humane dhe vullnetarizmin për t’u gjendur pranë shtresave në nevojë në këto momente të vështira. Ne inkurajojmë të gjithë ata që mendojnë se mund të ndihmojnë nëpërmjet Food Bank familjet në nevojë, të kontribuojnë në adresat si më poshtë:

<https://foodbank.al/kontributi-im/kontributet-financiare/>

<https://foodbank.al/kontributi-im/me-cfare-mund-te-kontribuoj-une/>

“Gjirofarma Sh.a.” dhe “Rotary Club Tirana International” bashkojnë forcat për një aksion humanitar në ndihmë të familjeve të policëve të rënë në krye të detyrës.

“Përvoja ime si anëtar i Rotary Albania më bën shpresëplotë se për veprime humanitare asnjëherë nuk është vonë dhe asnjëherë nuk është mjaft sado shumë që ne të bëjmë”

– tha Nikolla Gjoni, CEO i Gjirofarma.

AmCham është krenare për anëtarët e saj.



“Gjirofarma Sh.a.” dhe “Rotary Club Tirana International” bashkojnë forcat për një aksion humanitar në ndihmë të familjeve të policëve të rënë në krye të detyrës.

Ky bashkëpunim i dhuroi familjeve të atyre që kanë humbur jetën në krye të detyrës, furnizime me ndihma ushqimore nga produktet Gjirofarma.

“Përvoja ime si anëtar i Rotary Albania më bën shpresëplotë se për veprime humanitare asnjëherë nuk është vonë dhe asnjëherë nuk është mjaft sado shumë që ne të bëjmë” – tha Nikolla Gjoni, CEO i Gjirofarma.

Dhoma Amerikane është

krenare për anëtarin e saj Gjirofarma dhe vullnetarizmin në ndihmë të qytetarëve. Ne inkurajojmë të gjithë anëtarët që kanë mundësi të bëhen pjesë e iniciativave të tilla, të sjellin një kontribut konkret në këto momente të vështira për vendin, si shprehje e përgjegjësisë së tyre sociale.

Gjirofarma Sh.a. dhe Rotary Albania do të zgjerojnë edhe me tej veprimtarinë e tyre humanitare, duke përfshirë Rotary Clubs in Albania dhe me vonë edhe Rotary International dhe ftojnë çdo anëtar që dëshiron të bëhet pjesë e iniciativës së tyre t’u bashkohet.

COVID-19

Paketa e Zgjatur / Rama: Do të përfshihen gjithashtu qiramarrës dhe njerëz të paafte për të punuar - Scan-tv.com

Në listën e kategorive që do të përfshihen për të përfituar ndihmë financiare direkte ose indirekte janë profesionet e lira, gomisteritë, lavazhet, serviset, pastrimet kimike, rrobaqepsitë, berberët, hidraulikët, taksistët, punonjësit e transportit publik, punonjësit e agjencive turistike, punonjësit e kancelarive, etj.

Denaj: Një paketë që i adresohet biznesit të madh po diskutohet - A2 News

Anila Denaj, Ministre e Financave dhe Ekonomisë, tha për A2 Business Week se Qeveria po diskuton një paketë që do të vijë në ndihmë edhe bizneseve të mëdha. "Po diskutojmë një paketë të dytë, që i drejtohet bizneseve me numër të madh punonjësish, por nuk kam autorizim të flas për të. Po diskutohet dhe shumë shpejt do të njoftohet nga zoti Kryeministër", u shpreh Denaj.

Financial aid for small businesses, 42% of verified applications are rejected - Monitor.al

Sipas grafikëve të publikuar, deri tani kanë aplikuar 86.6 mijë punonjës dhe 49.2 mijë biznese. Nga këta, janë verifikuar 35.8 mijë punonjës dhe 21.4 mijë biznese.

Dhoma e Sipermarrjes së Kosovës, leter drejtuar Ramës dhe Kurtit: Lehtësoni qarkullimin e biznesit midis Kosovës dhe Shqipërisë - Monitor.al

Oda e Afarizmit e Kosovës i është drejtuar me një letër Kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, dhe atij të Kosovës, Albin Kurti, si dhe ministrave përkatës të të dyja vendeve, për krijimin e lehtësive në qarkullim për bizneset e Shqipërisë dhe Kosovës. Oda e Afarizmit të Kosovës kërkoi që të krijohen lehtësi tregtare për lëvizje të biznesmenëve në këtë kohë krize, për bizneset nga Kosova dhe Shqipëria.



Masat për COVID-19 / Bankave do t'ju ndalohet përkohësisht nga shpërndarja e fitimeve - Scan-tv.com

Banka e Shqipërisë do t'iu ndalojë përkohësisht bankave tregtare shpërndarjen e dividendëve. Vendimi pritet të merret në mbledhjen e ardhshme të Këshillit Mbikëqyrës dhe është një masë kujdesi, për shkak të situatës që po krijohet në ekonomi nga kufizimet e vendosura në muajin mars.

Emigrantët e Huaj në Shqipëri, AIDA: Ja çfarë ndryshon në procedurën për të huajt - Scan-tv.com

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve ka informuar mbi Ligjin Nr. 13/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin "Për të huajt" të ndryshuar". Fushat të cilat kanë ndryshuar janë: politika e vizave; politika e qëndrimit dhe politika e punësimit të të huajve.

COVID-19, FSA (AMF) kërkon që kompanitë e sigurimeve të pezullojnë shpërndarjen e dividendëve - Monitor.al

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare bëri me dije se u ka kërkuar së fundmi shoqërive të sigurimit të pezullojnë procedurat e shpërndarjes së dividendit. Masa e njoftuar nga AMF-ja vjen në kushtet e situatës së krijuar nga koronavirusi dhe sipas rekomandimeve të Autoritetit Europian të Sigurimeve, kërkohet ruajtje e likuiditetit dhe treguesve financiarë në tregjet në mbikëqyrje.

Sinkronizimi i politikave mes Shqipërisë e Kosovës, një shans për të shpëtuar turizmin këtë vit - Monitor.al

Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), në një raport të fundit të saj për rezistencën e vendeve ndaj pandemisë së Covid-19,

gjeti se Shqipëria është më e rrezikuar nga turizmi, për shkak të peshës së lartë që ka ai në ekonomi, me mbi 20% të Prodhimit të Brendshëm Bruto. Por, ka një shpresë që turizmi të funksionojë këtë vit. Ai është te fquinjtë tanë, Kosova, por edhe Maqedonia

Miratohet VKM / Si do të funksionojë garancia e kredisë për bizneset e mëdha - Monitor.al

Sipas kushteve të miratuara në vendimin e Këshillit të Ministrave, Vlera e Huasë e vendosur në dispozicion nga Bankat për çdo Biznes pjesëmarrës mund të variojë në përputhje me kërkesën e paraqitur nga Biznesi, por duke mos tejkaluar vlerën e 3 pagave mujore bruto të punonjësve të deklaruar nga Biznesi.

Taksat: Ku të ankoheni kur keni probleme me marrjen e ndihmës financiare - Monitor.al

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve bën me dije për të gjithë të interesuarit, të cilët konsiderojnë se mund të jenë përfitues të ndihmës financiare, por kërkesa e tyre është refuzuar, se kanë mundësi të paraqesin kërkesën/ankesën e tyre duke komunikuar përmes adresës e-mail të Drejtorisë Rajonale, ku ata banojnë.

Krizja COVID-19, numri i të papunëve mund të rritet në 50-60 mijë njerëz brenda një muaji - Monitor.al

Numri i të papunëve në vend, si shkak nga mbyllja e bizneseve nga përhapja e koronavirusit në vend, mund të rritet në 50-60 mijë persona brenda një muaji. Sipas Ministres Denaj, për kategorinë që humb vendin e punës, Qeveria do të ofrojë një ndihmë sa gjysma e pagës minimale në vend, që është në nivelin e 27 mijë lekëve.

Taksat: Afatet e deklarimit dhe pagimit të detyrimeve tatimore nuk kanë ndryshuar! - Monitor.al

Administrata Tatimore sjell në vëmendje te të gjithë tatimpaguesve se afatet e deklarimit dhe pagesës së detyrimeve tatimore nuk kanë ndryshuar. Afati i parë i deklarimit është data 10 prill, në të cilën të gjithë subjektet e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), duhet të dorëzojnë në mënyrë elektronike, nëpërmjet e-filing, regjistrimet e Librave të Shitjes dhe të Blerjes, për periudhën mars 2020.

Qendrat e kontrollit teknik të makinave ende të mbyllura nga koronavirusi, Drejtoria e Transportit: Nuk do ketë gjobë - Monitor.al

Kontrolli teknik i automjeteve vazhdon të jetë i mbyllur për shkak të pandemisë së koronavirusit. Por, nëse data e kontrollit teknik të automjeteve ka qenë gjatë ditëve kur shërbimi i SGS-së ka qenë i mbyllur për shkak të emergjencave, qytetarët janë të detyruar të qarkullojnë pa bërë kolaudimin dhe nuk do të gjobiten.